



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi


KULTURA E NJERIUT



E-bulletin

Nentor, 2018

Në Athinë Konferenca Speciale e Sindikatave të Arsimit të Evropës



Edwards: Të mobilizohemi që as njëherë të mos humbim betejën

Janë takuar në Athinë te 132 sindikatat nga 52 shtete të Evropës në Konferencën speciale të organizuar nga Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE). Në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin e Evropës mori pjesë edhe delegacioni i SBASHK-ut, i cili po përfaqësoi në mënyrë meritore arsimin e Kosovës duke marrë pjesë e duke kontribuar në seancat plenare dhe ... (faqe 5)

SBASHK-u në bashkëpunim me GIZ-in mbajtën konferencë të rëndësishme



Angazhime të vazdueshme në shërbim të arsimit edhe më të....(faqe 6)



Intervistë me mësimdhënësin dhe veprimtarin sindikal Besim Haliti

Është fisnik, por edhe sfidues profesioni i mësimdhënësit ... (faqe 3)

SBASHK në Kongresin e Sindikatave të Arsimit të Sllovenisë



Miqësi e vjetër dhe respekt i ndërsjellë

Në qytetin e bukur bregdetar Portorozh ka mbajtur Kongresin e 10-të Sindikata e Arsimit të Sllovenisë (SVIZ). ... (faqe 9)

SBASHK edhe në Kongresin e Sindikatave të Arsimit të Holandës



Takim me miqtë e vjetër të arsimit tonë

Sindikata e Arsimit të Holandës falë përkushtimit të mikut të vejtur të arsimit shqip, Valter Dreshler ka qenë edhe në kohët e vështira të Kosovës ... (faqe 10)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial



Në çdo muaj nëpër vite e dekada kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme për kombin tonë, por janë marsi e nëntori që stolisen me më shumë data e ngjarje të rëndësishme. Marsi sjell Ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe. Marsi kujton nëpër kohë e breza Epopenë e lavdishme të UÇK-së dhe luftën e madhe e sakrificën sublime të Komandantit legjendar dhe familjes Jashari në Prekaz. Në mars me krenari lartësojmë kujtimin për ngjarjet dhe personazhet e tyre.

Një muaj tjetër që shënon data e ngjarje të krenarisë sonë është edhe nëntori. Me ardhjen e këtij

muaji njerëzit shpalosin kujtimet personalitetet e shquara dhe angazhimet e tyre sublime për atdheun. Është ky muaj i flamurit tonë kombëtar, në shenjë respekti për të cilin, edhe në këtë nëntor u organizuan manifestime të shumta dhe njerëzit uronin njëri-tjetrin me shumë se për festa të tjera. Po në nëntor kujtojmë Komandantin legjendar Adem Jashari në ditelindjen e tij. Ky muaj me datat e tij të historisë së lavdishme sikur kërkon nga ne angazhime të shtura kudo jemi në shërbim të unitetit dhe në përpjekjet për ecje përpara në arsim, kulturë, shëndetësi e kudo për ta krijuar një ardhmëri edhe më të mirë për brezat. Këto angazhime ua kemi borxh personaliteteve të kombit që janë skalitur me shkronja të arta në faqet e historisë së lavdishme të kombit tonë. Respekt i përjetshëm për njerëzit e pendës e pushkës dhe për angazhimet e veprat e tyre madhore në shërbim të gjuhës, kulturës dhe lirisë së atdheut.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos heziton të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rrëth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësin dhe veprimtarin sindikal Besim Haliti



Është fisnik, por edhe sfidues profesioni i mësimdhënësit

Besimi është profesor i historisë dhe tanë është emëruar koordinator i cilësisë për të ndihmuar kolegët e tij në angazhimet e vazdueshme për arsim edhe më të mirë. Besimi ka gatishmërinë për angazhime

vullnetare për të përkrahur e ndihmuar proceset pozitive. Ka kohë që angazhohet në cilësinë e trajnerit në trajnimet e organizuara nga SBASHK. Pranoi me kënaqësi t'u përgjigjet pyetjeve përgazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Besim Haliti?

Besimi:

Jam i lindur më 4 nëntor 1977 në Viti. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kam mbaruar në Viti. Ne vitet e okupimit, më 1995 jam regjistruar si student i rregullt në Fakultetin Filozofik, drejtimi histori ku kam mbaruar studimet katërvjeçare të barazvlefshme me 240 kredi (ects). Gjatë viteve 2008-2010 kam vazduuar studimet master në Fakultetin filozofik drejtimi Histori e kohës moderne, momentalisht jam duke e punuar tezën për të mbrojtur titullin master i historisë. Gjatë kohës sa isha në studime ne vitin 1996-97 isha i angazhuar në Unionin e pavarrur të studentëve si delegate i UPS. Në përvjetorin e themelimit të UP-së, datë 15 shkurt 2001, jam nderuar me diplomën student i dalluar në UP. Pas diplomimit më 2002, jam pranuar si arsimtar në SHFMU "Ahmet Hajdari" në fshatin Beguncë të Vitisë ku kam punuar deri në vitin shkollor 2008-09. Nga shtatori I vitit 2009 jam pranuar në gjimnazin "Kuvendi i Lezhës" në Viti ku vazhdoj të punoj edhe sot në detyrën e Koordinatorit të cilësisë.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot ?

Besimi:

Ushtrimi i profesionit të mësimdhënësit, në ditët e sotme është, sa motivues e fisnik po aq sfidues dhe me përgjegjësi. Në kohët e sotme mësimdhënia është shumë më sfiduese ngase janë rritur kërkesat dhe pritshmërinë si nga ana e nxënësve, prindërve, tregut të punës po dhe shoqërisë në përgjithësi. Burimet e informacionit, si ato bazike po ashtu edhe materialet alternative, janë më të shumta duke e bërë sfidë në vete përzgjedhjen dhe ofrimin e materialeve për nxënës nga ana e mësimdhënësve. Po ashtu edhe format e punës, strategjitet dhe teknikat mësimore kanë shënuar avancim e duke synuar gjithmonë ofrimin e njojurive cilësore dhe të përdorshme në jetë, punë në mjedisin ku jeton. Inovativiteti dhe kreativiteti i mësimdhënies ka shënuar nivele të larta duke e kthyer në sfidë në vete përcjelljen dhe aplikimin e njojurive të reja në mësimdhënie.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut ?

Besimi:

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës është dëshmuar si organizata më serioze nga të gjitha organizimet sindikale në Kosovë dhe më gjërë. Kur e themi këtë e kemi parasysh përqindjen e lartë të numrit të anëtarëve në sindikatë që i ofrohet shumë shifrës 100% i të punësuarve në sektorin e arsimit. Një shtrirje aq e madhe në bazë shtron para vetes angazhime shumë serioze nga ana e kryesisë së saj e cila, në gjykimin tim po dëshmon një lidership të shkëlqyeshëm në avokimin e interesave të mësimdhënësve dhe stafit arsimor duke shënuar një varg të arriturash si: nënshkrimin e kontratës kolektive, pjesëmarrjen në hartimin e të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve administrative që prekin fushën e arsimit, angazhimin dhe kontributin e saj në Këshillin Ekonomik Social (KES), Avokimin e zërit të mësimdhënësve për të mbrojtur interesat e tyre si bie fjala çështja e koeficientit të pagës së mësimdhënësve, realizimin e pagave suplementare dhe të drejtave tjera të parapara me Kontraten Kolektive, angazhimin e saj në ngritjen e cilësisë në arsim në përmjet konferencave, trajimeve dhe punëtorive të ndryshme etj.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Arsimim i sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?

Besimi:

Krahas angazhimeve rreth avancimit të pozitës së mësimdhënësve si në aspektin ligjor po ashtu edhe material, ne besojmë fuqishëm se angazhimi I SBASHK-ut në ngritjen e cilësisë në arsimin Kosovar do t'i shërbente në radhë të pare shoqërisë por edhe ngritjes së imazhit pozitiv të partnerët e tjerë social, qoftë ata institucional ose jo institucional si bie fjala komuniteti i prindërve.

Arsimimi sot:

Si ndiheni si trajneri SBASHK-ut, në trajnimet me mësimdhënësit?

Besimi:

Përvoja ime si trajner në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” është ndër gjërat më motivuese që më ka ndodhur këtë vit. SBASHK-u, për kundër mungesës së kapacitetit, përtej mundësive dhe resurseve që ka në dispozicion është duke e kryer një punë të madhe në aspektin e ngritjes profesionale të mësimdhënësve gjatë karrierës së tyre duke i fascinuar anëtarët e saj si në aspektin e ngritjes së cilësisë në arsim, po ashtu edhe në licencimin dhe rilicencimin e tyre duke i përbushur kriteret e parapara me Udhëzimin administrative 05/2017. Të jesh pjesë e këtij procesi pozitiv në SBASHK është ndjenjë e bukur dhe shumë pozitive.

Arsimimi sot:

Çka të shtyri të angazhohesh si trajner në programet e SBASHK-ut?

Besimi:

Nevojat rreth ngritjes profesionale të mësimdhënësve, sfidat me të cilat po përballemi si shtet për të ngritur

një sistem arsimor cilësor e llogaridhënës, avokimi dhe adresimi i duhur i shkeljes së të drejtave të punëtorëve, dëshira për punë vullnetare në SBASHK duke e pasur parasysh angazhimin e saj në këtë sferë të rëndësishme të dialogut social në Kosovë ishin disa nga arsyet le te themi të angazhimit tim si trajner në programet e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Çka ju sugjeroni mësimdhënësve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?

Besimi:

Të gjithë mësimdhënësve dhe punëtorëve arsimor ju themi që “Ne jemi një familje e madhe” dhe i mbrojmë të drejtat e tyre pavarësisht nëse janë ose nuk janë pjesë e SBASHK-ut, por kur t'i japim krahun njëri -tjetrit ne bëhem më të forte dhe zëri ynë dëgjohet aty ku duam ne!

Arsimim i sot:

Çka do të veçonit nga trajnimet e mbajtura?

Besimi:

Nga trajnimet e mbajtura në programin e SBASHK-ut do të veçoja gatishmérinë e lidershipit të sindikatës për të monitoruar dhe mentoruar secilin trajnim duke ofruar fascilim të plotë në avokimin e të gjitha kërkuesave të anëtarëve të saj si dhe besimin e madh në organizatën tone nga ana e anëtarësisë si rezultat I sukseseve të përmendura më lartë.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Besimi:

Dialogu social në Kosovë edhe pse i zhvilluar pas luftës së fundit për shkak të rrëthanave shoqërore e historike, ka shënuar të arritura të admirueshme dhe storja më e sukseshtme në këtë proces, në gjykimin tim është puna e SBASHK-ut!



Gjatë muajit



ETUCE Special Conference

Athens, 26-28 November 2018

Në Athinë konferenca speciale e sindikatave të arsimit të Evropës

Edwards: Të mobilizohemi që as njëherë të mos humbim betejën

Janë takuar në Athinë te 132 sindikatat nga 52 shtete të Evropës në Konferencën speciale të organizuar nga Komiteti i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE). Në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin e Evropës mori pjesë edhe delegacioni i SBASHK-ut, i cili po përfaqësoi në mënyrë meritore arsimin e Kosovës duke marrë pjesë e duke kontribuar në seancat plenare dhe në punën në grupe.



Në hapje të kësaj ngjarje me rëndësi për arsimin e Evropës presidentja e ETUCE, Kristine Blower duke u nisur nga raportimet për situatën nga sindikatat kudo në shtetet e Evropës, ka dekluaruar se kudo në Evropë arsimi po përballet me sfida dhe

koha kërkon mobilizim të shtuar të sindikatave, që kanë më shumë 11 milionë anëtarë, në mbrojtje të të drejtave të punëtorëve arsimor dhe në realizimin e kërkuesave të tyre legitime.



Edhe drejtoresha e ETUCE, Suzan Flocken ka alarmuar se arsimi në kontinentin e vjetër po përballet me probleme të shumta e nga më të ndryshmet dhe prandaj, si tha ajo në këtë Konferencë duhet të jemi të përkushtuar për të dhënë ide e për të nxjerrë Rezoluta që janë në shërbim të mbrojtjes së arsimit dhe të mësimdhënësve në misionin e tyre të shenjtë e human.

Se kjo Konferencë kishte rëndësi të veçantë e dëshmon edhe pjesëmarrja e sekretarit të përgjithshëm të Internationales Botërore të Arsimit, David Edwards. Duke iu drejtuar pjesëmarrësve në këtë konferencë, sekretari i përgjithshëm i Internationales Botërore të Arsimit, z. David



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Edvards. Sekretari i përgjithshëm i EI-së ka kujtuar se raportet dhe komunikimi i vazhdueshëm me sindikatat kudo në Evropë e botë tregojnë se të 31 milionë anëtarët e angazhuan në EI po përballen me sfida e probleme të shumta dhe prandaj kërkon mobilizim i vazhdueshëm i sindikatave të arsimit. "Mësimdhënësit në Evropë po përballen me sfida të shumta dhe janë të atakuar nga të gjitha anët. Pra, kemi sfida të mëdha para vetës por së bashku mund t'ia dalim. Ne duhet të organizohemi dhe të mobilizohemi që asnjëherë mos ta humbim betejën." ka alarmuar sekretari i përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit, David Edvards.



Delegacioni i SBASHK-ut, i përbërë kryetari Rrahman Jasharaj dhe delegatët e Konferencës Vjollca Shala e Ymer Ymeri, janë angazhuan gjatë seancave plenare dhe në tryezat e punës për të dhënë kontribut në rrjedhën e mbarë të kësaj ngjarje të rëndësishme dhe në nxjerrjen e Rezolutave që do t'u drejtohen qendrave të vendosjes dhe institucioneve të

shteteve të Evropës për një qasje shumë më korrete ndaj lirive sidnikale dhe zgjedhjes së problemeve të shumta, që janë ngritur edhe në këtë Konferencë.



Në seancën përmbyllëse delegatët e kësaj Konference kanë nxjerr Rezoluta të rëndësishme për sindikatat dhe arsimin në tërësi nga të cilat do vëçuar: Rezoluta për dialogun e mirëfilltë social, e cila kërkon korrekëtësi dhe angazhim serioz të institucioneve në dialog e sindikatat, Rezoluta për fuqizimin e lirive akademike, Rezoluta që fton qeveritë Evropiane dhe Ministritë e Arsimit që të përfshijnë sindikatat e mësimdhënësve në të gjitha vendimet që ndikojnë në profesionin dhe sistemin arsimor dhe të marrin parasysh këshillat dhe vërejtjet e tyre.

SBASHK-u në bashkëpunim me GIZ-in mbajtën konferencë të rëndësishme Angazhime të vazhdueshme në shërbim të arsimit edhe më të mirë



Janë të shumta e domethënëse angazhimet e SBASHK-ut edhe në përpjekjet për arsim edhe më të

mirë në Kosovë. Në kuadër të kësaj sindikata jonë organizoi konferencën njëditore për komunitetet e të mësuarit së bashku, me titull "Forume inovative për një qëllim të përbashkët - përmirësimi i rezultateve të nxënësve".

Duke nisur me punimet e kësaj Konference kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka kujtuar se aktivitetet e tillë sindikata i organizon krahas veprimtarisë së saj të përhershme në mbrojtje të statusit të mësimdhënësve dhe përpjekjeve të saj për realizmin e kërkesave të anëtarësisë.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



“SBASHK-u përveç angazhimeve që i ka në bazë të statutit në përpjekjet për realizimin e kërkeseve të mësimdhënësve, po dëshmohet gjithnjë se është angazhuar edhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim”, është shprehur Jasharaj.



Në këtë Konferencë MASHT-in e ka përfaqësuar zëvendësministri Heset Sahiti. Ai shprehu kënaqësinë e tij që u drejtohej një audience të tillë, duke i vlerësuar lartë aktivitetet e SBASHK-ut në përmirësimin e cilësisë në arsim.

“SBASHK-u është njëra ndër organizatat shumë të rëndësishme dhe në historinë në saj ka shërbyer si gjenerator i ndryshimeve pozitive në shoqërinë tonë”, ka dekluaruar Sahiti.



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi ka përrshëndetur këtë angazhim duke thënë se: “Edhe përkundër punës së deritanishme të institucioneve, arsimi nuk është akoma prioritet i politikëbërjes në Kosovë”, ka vlerësuar Kurteshi duke apeluar që MASHT-i dhe organet tjera përgjegjëse që të rrisin buxhetin për arsimin. Ai pastaj në fjalën e tij ka shtuar se :

“Nuk ka temë më të rëndësishme sesa që të flitet për cilësinë e arsimit, sepse vetëm kështu mund të dalim nga kjo gjendje e vështirë ekonomike që e ka kapluar vendin. Komisioni për Arsim është angazhuar edhe në procedimin e ligjit për mësimdhënësit e viteve ’90-a dhe mund të them se shumë shpejt do të procedohet në Kuvend”.



Duke i përrshëndetur pjesëmarrësit e konferencës në emër të GIZ-it, Rrezarta Zhinipotoku-Behluli, e cila e ka udhëhequr projektin e komuniteteve të të mësuarit së bashku, ka thënë se që nga themelimi i këtyre grupimeve ka filluar planifikimi në mënyrë zyrtare. “E gjithë kjo ka pasur për qëllim; përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe cilësisë së arsimit në Kosovë. Zhinipotoku në fjalimin e saj i ka bërë thirrje zyrtarëve të sistemit të arsimit në Kosovë, që t'i përkrahin komunitetet e tillë të cilat përmes këmbimit të praktikave të mira, ndihmojnë në arrijen e rezultateve më të mira të nxënësve”, ka thënë Zhinipotoku.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Sesionet e kësaj konference i ka hapur, Selim Mehmeti, i cili ka prezantuar raportin e punës së këtyre komuniteteve në Kosovë për një periudhë pesë vjeçare. Në prezantimin e tij me titull “Puna e komuniteteve të mësuarit së bashku në shkollat e Kosovës (2013-2018)”, Mehmeti, ka thënë që ngecjet kryesore në punën e këtyre rrjeteve është dokumentimi i aktiviteteve të tyre përmes procesverbaleve dhe formave tjera zyrtare të raportimit. Ai ka thënë që praktikat e tillë të organizmit në komunitete të mësuarit duhet të vazhdojnë pasi që në shumë raste ka pasur rezultate të dukshme në përmirësimin e cilësisë së arsimit.



Njohësi i mirë i rrethanave dhe aktualitetit në arsimin e Kosovës Osman Buleshkaj në prezantimin e tij është fokusuar në praktikat e mira të funksionimit të rrjeteve profesionale të udhëheqësve arsimor, duke dhënë shembuj se si një organizim i tillë mund të bëhet pjesë e kulturës së punës së drejtoreve të shkollave në Kosovë.

Duke folur për rrjetet e ndryshme të mësuarit së bashku, Buleshkaj ka thënë që këto rrjete nuk duhet të funksionojnë njëjtë, meqë sipas tij, secili rrjet apo komunitet i të mësuarit së bashku ka specifikat e tij.



Drejtoresha e Shkollës së Gjelbër në Prishtinë, Fahrije Latifi Ratkoceri, në prezantimin e saj ka ofruar shembullin e shkollës që udhëheq si një formë e mirë e vetorganizimit edhe pse nuk është pjesë e organizimeve prej 21 komuniteteve të mësuarit së bashku.

Gani Ahmetxhekaj, ish drejtor i prej shkollave që ishte pjesë e këtij aktiviteti ka prezantuar temën "Bashkëpunimi i drejtoreve të shkollave të komunitetit të mësuarit së bashku në procesin e planifikimit zhvillimor dhe sigurimin e cilësisë në performancën e shkollës". Në prezantimin e tij, Ahmetgjekaj ka kërkuar që të hartohej një bazë ligjore për punën e komuniteteve të mësuarit së bashku në formë të Udhëzimit Administrativ.

"Drejtoritë Komunale të Arsimit të mbështesin, monitorojnë dhe të nxitin punën e Komuniteteve të Mësuarit së Bashku, të ndahet një buxhet solid për punën këtyre komuniteteve, inspektorati i Arsimit krahas punës së tyre të monitorojnë edhe punën e ekipeve të komuniteteve, si dhe të harothen planet e veprimit për to", ka rekomanduar Ahmetxhekaj.



Në sesionet e konferencës, ka folur edhe Arlinda Bajgora, trajnere e komuniteteve e mësuarit së bashku, e cila ka thënë se praktikat e mira të këtyre organizimeve duhet të bëhen pjesë e kulturës së punës së mësimdhënësve dhe udhëheqësve të institucioneve arsimore. Sipas saj, sfidat kryesore në realizmin e këtij lloj të bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve mbeten; mungesa e infrastrukturës, mungesa e motivimit, ngarkesa gjatë zbatimit të kurrikulës, mungesa e veticinitativës, mungesë e përkrahjes nga udhëheqësia e shkollës dhe DKA-të.

Në konferencë ka prezantuar edhe Leonida Kelmendi - Imeri, mësimdhënëse e shkollës "Avdullah Shabani"

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

në Mitrovicë, shkollë kjo e cila ka qenë pjesë e komuniteteve të mësuarit së bashku. Kelmendi-Imeri, duke folur për praktikat e shkollës së saj, ka thënë që ky organizim, ka ndihmuar në përgatitjen më të mirë të mësimdhënësve dhe rrjedhimit edhe arritje më të mira të rezultatit të nxënësve.



Ismet Potera, ka trajtuar temën e motivimi nga kënaqësia në punë dhe ndikimi në të nxënënit në komunitet". Potera ka paraqitur me këtë rast, pjesë nga hulumtimi i tij përmes të cilit ka identifikuar format më të mira të motivimit të mësimdhënësve për punën e tyre.



Po ashtu, Besa Hoxha Krasniqi në konferencë ka paraqitur një qasje për politikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë duke ofruar shembuj nga praktikatat e te nxënënit. Ajo në prezantimin e saj, ka folur edhe për rolin e udhëheqësve të aktivave profesionale në përkrahje të mësimdhënësve.

Konferenca e organizuar nga SBASHK-u dhe GIZ-i ka ofruar qasje të reja në bashkëpunimin e institucioneve shkollore dhe mësimdhënësve me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit. Komunitetet e të mësuarit së bashku në Kosovë kanë filluar punën që nga viti 2013.

SBASHK në Kongresin e Sindikatave të Arsimit të Sllovenisë **Miqësi e vjetër dhe respekt i ndërsjellë**



Në qytetin e bukur bregdetar Portorozh ka mbajtur Kongresin e 10 Sindikata e Arsimit të Sllovenisë (SVIZ). Në këtë ngjarje të veçantë për arsimin slloven ishin të ftuara SBASHK dhe shumë nga sindikatat simotra nga Ballkani e Evropa .

Në hapje të këtij Kongresi, pasi ka përvendetur mysafirët, sekretari i përgjithshëm i SVIZ, Branimir



Shtrukel bërë një analizë të aktiviteteve të Sindikatës Sllovene të Arsimit duke u ndalur edhe te sfidat. "Sindikatat e arsimit në Slloveni dhe në shtetet tjera po përballen me sfida dhe prandaj shtohet nevoja për bashkëpunim dhe solidaritet", ka thënë Shtrukel i cili pastaj ka shtuar se Sindikata e Arsimit të Sllovenisë (SVIZ) ka bashkëpunim të shkëlqyer me sindikatat simotra nga vendet e Ballkanit dhe me ato në tërë Evropën.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Delegacioni i SBASHK-ut gjatë pjesëmarrjes në Kongresin e kolegëve slloven ka zhvilluar takime me sekretarin gjeneral të Sindikatës së Arsimit të Sllovenisë, Branimir Shtrukel, me kryetaren e kësaj sindikate Jelka Jelcki dhe me përgjegjësin për bashkëpunim me jashtë Sandi Modrian, por edhe me përfaqësues të sindikatave nga shtete të tjera.



"Me vite e dekada kemi bashkëpunim të shkëlqyer me SBASHK-un dhe këtë bashkëpunim do ta vazhdojmë. Ju përgëzojmë për punën dhe angazhimet që po bëni dhe ju falënderojmë që po na informoni për aktualitetin në arsimin tuaj. Do ta keni gjithmonë përkrahjen tonë", është shprehur sekretari i

përgjithshëm i SVIZ, Branimir Shtrukel në takimin me delegacionin e SBASHK-ut. Ai është ndier i nderuar duke pranuar një dhuratë modeste me hartat e dy shteteve të punuara me kristalet e Trepçës."Kjo dhuratë simbolike me dëshmon miqësinë e sinqertë mes dy vendeve.

Një moment i veçantë për delegacionin e SBASHK-ut dhe ata të Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë ishte



takimi me kryetarin e Shoqatës Shqiptare "Iliria" të Istres sllovene. Kryetari i kësaj Shoqate Heset Ahmeti është ndjerë i lumtur pse po takon përfaqësues të arsimit nga Kosova dhe Shqipëria dhe pastaj u ka shpjeguar atyre për aktivitetet kulturore që zhvillon kjo Shoqatë duke kontribuar në ruajtjen dhe kultivimin e këngës, valles dhe traditave shqiptare.

SBASHK-u falënderon shqiptaren Vlora Konjuhi dhe bashkëshortin e saj për angazhimet e tyre dhe ndihmën në komunikim me nikoqirin, me sindikata tjera, por edhe për pritjen vëllazërore dhe shoqërimin e vizitat pjesë të ndryshme të komunës së Portorozhit dhe qytetave tjera bregdetare.



SBASHK-u edhe në Kongresin e Sindikatave të Arsimit të Holandës

Takim me miqtë e vjetër të arsimit tonë



Sindikata e Arsimit të Holandës falë përkushtimit të mikut të vjetër të arsimit shqip, Valter Dreshler ka

genë edhe në kohët e vështira të Kosovës përkrahëse e madhe e SBASHK-ut. Kjo sindikatë ka mbajtur Kongresin e saj në qytetin Utrih duke ftuar edhe shumë nga sindikatat simotra nga e tërë Evropa. Mysafirë të kësaj ngjarje të rëndësishme për arsimin e Holandës ishte edhe SBASHK-u i përfaqësuar nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri. Para fillimit të Kongresit, sindikata holandeze e arsimit (AOB) ka zhvilluar



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

bashkë me mysafirët një varg aktivitetesh sindikale në formë të tryezave dhe punëtorive me tema aktuale për sindikatat. Këto aktivitete janë zhvilluar në shtëpinë muze të sindikatave të Holandës.



Në hapje të punimeve të Kongresit kryetarja e Sindikatave të Arsimit të Holandës, Liezbet Verhergen ka përvendosur mysafirët dhe delegatët e pastaj ka bërë një analizë të aktiviteteve të shumta që kjo sindikatë ka zhvilluar brenda kufijve të shtetit të tyre, por edhe në nivel ndërkombëtar në mbështetje të arsimit dhe të punësuarve në këtë sektor shumë të rëndësishëm.

Kongresi ishte një moment shumë i mirë që delegacioni i SBASHK-ut të takohej e të bashkëbisedonte me miqtë e vjetër të arsimit tonë. Ky delegacion u takua me veprimtarin e madh sindikal Valter Dreshler, me ish sekretarin gjeneral të Internacionales Botërore të Arsimit Fred Van Liven, me veprimtaren e njohur Trudi Kerperien, por edhe me udhëheqësin më të lartë aktual të Internacionales Botërore të Arsimit, sekretarin gjeneral, David Edwards, drejtoreshën e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, znj. Susan Flocken dhe me kryetaren e Sindikatave të Arsimit të Holandës, Liezbet Verhergen.



Një moment plot emocione ishte edhe takimi i delegacionit të SBASHK-ut me ish sekretarin gjeneral të Internacionales Botërore të Arsimit ,Fred Van Liven. Ky mik i vjetër e i dëshmuar i arsimit ët Kosovës iu gëzua këtij takimi me përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe i përgëzoi ata për punën dhe përkushtimin duke i këshilluar që të vazhdojnë pa u ndalur në mbrojtjen e të drejtave dhe realizimin e kërkesave të anëtarësisë së SBASHK-ut sepse, si tha ai, e kanë pasur dhe do ta kenë përkrahjen e Internacionales Botërore të Arsimit. Delegacioni i SBASHK-ut edhe kësaj radhe ka falënderuar mikun e madh të Arsimit të Kosovës, z. Liven për gjithë angazhimet e përkrahjen e në kohën e e okupimit të Kosovës, por edhe në gjithë vitet e pasluftës.



Miqësor e plot emocione ishte edhe takimi me ish udhëheqësin e AOb,Valer Dreshler bashkë me bashkëshorten e tij Xhenifer. Veprimtari i madh, e dikur sekretar i përgjithshëm i Sindikatës Holandeze të Arsimit, ndalej të momentet kur po vizitonte shpesh Kosovën në vitet e okupimit dhe kujtonte situata kur po ndante fatin me kolegët e tij nga e tërë Kosova në ato kohë plot vuajtje e sakrifica

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Takime të rëndësishme delegacioni i SBASHK-ut kishte edhe me sekretarin e tanishëm gjeneral të

Internacionales Botërore të Arsimit, z. David Edwards, dhe me drejtoreshën e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, znj. Susan Flocken. Në këtë dy takime të ndara delegacioni i SBASHK-ut u ka informuar bashkëbiseduesit për situatën aktuale në arsim dhe për sfidat me të cilat po përballet SBASHK për të marrë edhe një herë mbështetjen dhe përkrahjen e tyre të plotë. Delegacioni i SBASHK-ut është takuar edhe me përfaqësues të sindikatave të arsimit nga Italia dhe vende të tjera të Evropës.

Lartësim kujtimi për trimat e lirisë dhe për pishtarët e dijes **Mirënjohje e veçantë nga Shkodra për SBASHK-un**



Shoqata Atdhetare "Dukagjini" e Shkodrës, Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", Ansamblı Autokton "Rugova" dhe Teatri "Aleksandër Moisiu" i Pejës kanë organizuar një veprimtarë madhështore kulturore për të lartësuar kujtimin për trimat e lirisë dhe pishtarët e dijes. Mes shumë mësuesve e veprimtarëve në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe një delegacion nga Prekazi e Skenderaj, i udhëhequr nga Lulëzim Jashari. Sekretari i përgjithshëm i Shoqatës "Martin Dreshaj", Fraher Rraci ka për një shpalosje të aktiviteteve e angazhimeve atdhetare të njerëzve të pendës e pushkës nëpër vite, dekada e shekuj për të shprehur respektin e lartë për këta bijë e bija të atdheut.

Kryetari i Shoqatës "Dukagjini" nga Shkodra ka përcjellë respektin e kësaj pjese të Shqipërisë për familjen emblemë të Kombit, për komendantin Adem Jashari, për mësuesin Shaban dhe për gjithë njerëzit që në kohë plot furtuna kanë kryer misionin e tyre të

shenjtë për ta ruajtur gjuhën dhe kulturën shqipe. Duke lartësuar kujtimin për ta kjo Shoqatë ka dekoruar me titullin "Mehmet Shpendi" mësuesin Shaban Jashari dhe me titullin "Martin Vamaj" Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK). "Për punën vetëmohuese në shërbim të mësimit dhe përhapjes së gjuhës shqipe, të shkrimit dhe leximit të saj dhe edukimin atdhetar në shërbim të kombit shqiptar", ka thënë kryetari Sanaj teksha po dorëzonte mirënjohjen për SBASHK-un me emrin e shkrimit tarit, akademikut dhe albanologut të njohur shqiptar.



Me mjaft emocione në këtë veprimtarë ka folur edhe kryetari i Ansamblit "Rugova", prof. Vesel Nikçi, i cili ka shpalosur kujtime për arsimin shqip nëpër vite e dekada për të lartësuar kujtimin për të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në misionin e shenjtë të mësuesit për arsimim e edukim të brezave.

"Pishtarët e dijes dhe atdhetarët nëpër dekada e shekuj mbrojtën atdheun dhe gjuhën e bukur shqipe. Edhe ne mësimdhënësit e viteve të 90-ta duke ndjekur këta shembuj dhe duke ruajtur në zemër kujtimin për



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

mësuesin Shaban Jashari i përballua furtunat dhe arritëm të kryejmë misionin tonë të shenjtë. Kujtimi për figurat emblemë të atdhetarëve na bën "pathyeshëm karshi furtunave të pushtuesit", foli me

plot emocione në këtë veprimtari kulturore kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj duke falënderuar organizatorët

Kanë vazhduar trajnimet me mësimdhënës në Lipjan, Gjakovë, Viti e Pejë

Angazhim i vazhdueshëm i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Sa vinë e shtohen kërkesat e shtuara kudo në komunat e Kosovës për mbajtjen me ta të trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut. Duke dëshmuar se është në angazhim të vazhdueshëm në shërbim të anëtarësisë SBASHK-u ka kërkuar angazhimin e një numri trajnerësh të licencuar në mënyrë që trajnimet të mbahen sipas agjendës dhe planifikimit të bërë.

Trajnime të tillë për dialogun social, por edhe për udhëheqje e menaxhim janë mbajtur në shkolla të komunës së Lipjanit, Vitisë, Gjakovës dhe se fundi kanë nisur edhe në komunën e Pejës.



Trajnerët janë kujdesur që trajnimet të janë dinamike duke krijuar atmosferë pune e përkushtimi te pjesëmarrësit, të cilët janë bërë pjesë aktive e këtij aktiviteti. Kanë zgjuar interesim të madh veçmas temat: "Dialogu, sfidat dhe kujdesi në dialogun social" "Dialogu social në nivel kombëtar- partnerët e dialogut social", "Dialogu social dhe Këshilli Ekonomik Social", "Dialogu social në Këshillin e

Evropës" dhe tema të tjera. Njohuritë e fituara pjesëmarrësit i kanë dëshmuar në pjesën e detyrave e ushtrimeve në grupe.

Do theksuar se këto aktivitete, krahas qëllimit për trajnim të mësimdhënësve, kanë edhe një vlerë shtesë sepse në to po zhvillohet një bashkëbisedë për aktualitetin në arsim, për sfidat dhe po jepen ide me qëllim që aktivitetet e SBASHK-ut të janë edhe më të shumta e në shërbim të anëtarësisë.



Në shumë nga këto trajnime po merr pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahmnna Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Yméri, të cilët po përgjigjën në pyetjet e pjesëmarrësve të trajnimeve.



Duke parë se janë shtuar shumë kërkesat për këto aktivitete SBASHK-u do ta ngrit një komision dhe do ta punojë një plan të aktiviteteve të trajnimeve në komunat e Kosovës .



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

SBASHK-ut vazhdojnë t'i shtohen radhët

Në muajin nëntor edhe 268 anëtarë të rinj

Përkushtimi, angazhimi, korrektësia, transparenca, zëri unik e i fuqishëm në mbrojtje të kërkeseve të arsyeshme të anëtarësisë, mbrojtja e personalitetit të mësuesit, kujdesi për kolegët e pensionuar që të fitojnë pagat meritore me rastin e pensionimit, organizimi i shkëlqyer i pushimeve për qindra punëtorë nga e tërë Kosova, organizimi i trajnimeve për të ndihmuar punëtorët arsimor që të arrijnë numrin e kërkuar të orëve me rastin e licencave të punës, takimet e vazhdueshme me anëtarësinë dhe bashkëbisedat për të gjithë çështjet aktuale, informimi me kohë për aktualitetin, transparenca dhe komunikimi korrekt me mediet ka bërë që, jo vetëm të punësuarit në arsim, por dhe ata në sektorë të tjera ta shohin SBASHK-un si sindikatë shumë serioze dhe të organizuar mirë. Rezultat i kësaj është fakti i shtimit të radhëve. Faktet e shifrat flasin se çdo muaj ka ardhje të reja. Vetëm në muajin nëntor na u bashkuan edhe 268 anëtarë të rinj duke bërë kështu që të tejkalohet numri prej 22.000.

Jemi të sigurt se edhe ai numri i vogël i punëtorëve të arsimit që ende nuk ka vendosur do të bëhet pjesë e jona dhe ne i ftojmë EJANI BASHKË e në SBASHK. Bashkërisht e unik më lehtë do të përballemi me sfidat dhe më lehtë do t'i fitojmë betejat për realizimin e kërkeseve tonë legjitime dhe për një arsim edhe më të mirë.

| | | |
|---|--------------------------------------|---|
|  Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova -Government of Kosovo | |  |
| DORËZIMI-PRANIM I FORMULARËVE NË BEKTORIN E LISTË-PAGESAVE | | |
| SBASHK | 05.12.2018 | Date e pranimit: Pijzicë Komuna: |
| Ministria, Kuvendi Komunal apo Drejtoret i rezervuar | | |
| Gjithsej formularë të pranuar | 268 | |
| Punëtorë të ri | | |
| Ndryshime | | |
| Punëtorë të larguar | 4 | |
| Pagesa retroaktive | | |
| Të tjera (shëno) | | |
| Dorëzuar nga: Tel./ fax ose e-mail: | APROVITAHUETI NEXHËHJE BALAJ Ndal | |
| Kontrolluer dhe pranuar nga: | Nënshtrimi | |
| Autorizuar për procedim nga: | Nënshtrimi | |
| Gjithsej formularë | Janë proceduar | Nuk janë proceduar |
| Punëtorë të ri | | |
| Ndryshime | | |
| Punëtorë të larguar | | |
| Pagesa retroaktive | | |
| Të tjera | | |
| Proceduar nga: | Nënshtrimi Date e procedimit | |
| Ansyen e mos Aprovimit apo mos procedimin dhe hapat e mëtutjeshmë: | | |

